


ZËRI I GRUAS



NË DEMOKRACI

DEMOKRACIA E POPULLIT

ARIANISA (10), ELMEDINA (10), SHPEND (10), EURON (10), ERBLIN (10), ALTIN (10), ERIOLA (10)



Me shumë dashuri e kemi shkruar këtë artikull mbi demokracinë

Lexues të dashur e të nderuar, ju ftojme ta lexoni artikullin tonë dhe ta kuptoni rëndësinë e demokracisë. Një ditë u ndjeva pak e sëmurë. Prandaj, vendosa të vizitohem tek mjeku. Bashkë me mamën dhe motrën time shkuam në Qendrën e Mjekësisë Familjare në

e thashë këtë? Sepse, të dashur lexues, demokracia është baza e gjithë të mirave që i kemi ne si qytetarë demokratikë.

Të gjithë ne kemi të drejta të barabarta. Andaj, edhe rasti që e përmendëm më lart, tregon se të gjithë ne qytetarët pavarësisht moshës, racës, fesë, kombit apo ndonjë dallimi tjetër, jemi të barabartë në gëzimin e të drejtave. Për këtë arsye, ne shkojmë në shkollë, ne mund të marrim pjesë në procesin zgjedhor mbi moshën 18 vjeçare, etj. Kjo nënkupton se demokracia nuk bën dallime. Gjithsesi, se as ne nuk duhet të bëjmë dallime. Duhet t'i trajtojmë të tjerët me respekt dhe në mënyrë të barabartë. Duhet të jemi tolerant dhe paqësor. Këto janë edhe elementet mbi të cilat ndërtohet demokracia.

Demokracia është formë e qeverisjes, në të cilën udhëheq populli. Populli udhëheq me anë të votës në demokraci. Mos e harroni kurrë këtë!



Demokracia, kjo dhuratë e bukur që na bën të lumtur

Vushtrri. Aty kishte shumë njerëz që kërkonin ndihmë mjekësore. Mirëpo, ajo që më tërhoqi vëmendjen ishte një moshatare e imja, e cila i takonte komunitetit romë. Me sa dukej, as ajo nuk ndihej mirë dhe kishte ardhur me nënën e vet, sikurse edhe unë. Kur erdhi radha e saj, mjeku e mori me kujdes dhe tregonte respekt të madh ndaj saj. Kjo për shkak se doktorët bëjnë Betimin e Hipokratit, para se të fillojnë detyrën e tyre. Mua më bëri shumë përshtypje dhe thashë me vete: „Sa mirë që e kemi demokracinë“. A e dini pse



Gazetarët e demokracisë


POPULLI I KOSOVËS VENDOS VETË

ALTIONA (10), ERION (9), MUHAMET (9), SHKURTA (10), ERSAN (11), DIELLËZA (10), ENIS (11)



Populli zgjedh deputetët me anë të votës së lirë, në mënyrë që deputetët të punojnë për mirëqenien e tij

Demokracia është sistem i qeverisjes, i cili iu shërben qytetarëve duke iu sjellur atyre liri, arsimim për fëmijët dhe të gjitha grupmoshat dhe duke iu sjellur atyre punë e argëtim. Në demokraci, populli është i lirë të zgjedh. Sikurse ne fëmijët që zgjedhim dhe votojmë për njërin prej lojërave tona të preferuara, qytetarët të cilët kanë të drejtë vote, zgjedhin për kandidatin e preferuar për deputet, i/e cili/a do të punojë në Kuvend. Ne mendojmë se Kuvendi është institucioni më i rëndësishëm, sepse aty punojnë deputetët të cilët janë të zgjedhur direkt nga vota e popullit. Kuvendi është i përbërë nga deputetët më të mirë, sepse ata janë të aftë të krijojnë ligje për të vazhduar qeverisjen demokratike. Këtë fakt e theksoi edhe vizitorja jonë znj. Ulrike Lunacek, e cila tregoi se çfarëdo ligji që vo-



tohet në Kuvend ndikon tek i gjithë populli. Pikërisht në Kuvend më 17 shkurt 2008 është shpallur Pavarësia e Republikës së Kosovës. Aty nga 120 deputetë, 100 janë shqiptarë dhe 20 i përkasin komuniteteve jo shumicë, si serbë, boshnjakë, turq, etj. Por, meqenëse vizitorja jonë kishte qenë edhe deputete e Kuvendit të Austrisë, ne e pyetëm se sa deputetë janë atje. Ajo u përgjigj se Kuvendi i Austrisë ka 183 deputetë, sepse numri i popullsisë është më i madh se në Kosovë.



Në moshën 18 vjeçare do të dalim të votojmë



Ne dëshirojmë ta shohim vendin tonë të zhvilluar

RËNDËSIA E ZGJEDHJEVE NË JETËN TONË

DIAR (9), ERIONA (10), ALBIN (10), MEDINA (10), EURON (10), GRESA (10)




Duhet mirë të mendojmë para se të veprjmë...

Të dashur lexues, unë jam Medina dhe së bashku me shoqet e shokët e mi kemi zgjedhur që sot të jemi pjesë e Punëtorisë për Demokraci „Demos-ti“. Arsyeja se pse kemi vendosur të vijmë në këtë Punëtori është sepse kemi dëgjuar shumë fjalë të mira për mënyrën se si trajtohen nxënësit këtu. Informatat që i marrin, aktivitetet të cilat i zhvillojnë, e shumë gjëra të tjera mbresëlënëse, ndikojnë që nxënësit të bëhen shumë aktiv. Edhe ne kemi bërë zgjedhjen e duhur që kemi ardhur. Zakonisht para se të vendosim për veprimet tona, ne mendohe mi mirë. Hapat të cilët ne i hedhim, lënë gjurmë një kohë të gjatë. Ja disa raste se si mund të marrë kahje jo të mirë nëse ne nuk e bëjmë zgjedhjen e duhur. Nëse ndonjëri nga ne vendos të studioj në Fakultetin Juridik, vetëm sepse prindërit e tij/saj e kanë orientuar në atë drejtim, nuk do të ishte zgjedhje e duhur. Nëse aftësitë tona nuk përputhen me këtë drejtim, kjo mund të ndikojë në mos suksesin e kar-

rierës sonë. Ose, nëse zgjedhim të luajmë futboll në një mot me shi, përveç se do të na lagen rrobat tona, edhe shëndeti ynë do të rrezikohet.

Me kujdes të shtuar duhet të marrim pjesë edhe në procesin zgjedhor. Proces, ky i cili mirëpret të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët kanë arritur moshën 18 vjeçare. Po themi se duhet të kemi kujdes, sepse në momentin që ne e zgjedhim një përfaqësues, atëherë mandati i tij/saj do të zgjasë për 4 vjet.

Nga ajo çka ne sot mësuam, në Kosovë kemi dy lloje



të zgjedhjeve. Ato janë: zgjedhjet lokale, të cilat realizohen brenda një komune, ku qytetarët votojnë për të parin e komunës, pra kryetarin e saj; si dhe zgjedhjet qendrore të cilat realizohen në nivel nacional, ku qytetarët votojnë për deputetët, të cilët janë edhe përfaqësuesit e të gjithë qytetarëve. Sot, kokat tona i kemi mbushur me shumë informata të reja dhe zërrat tona me dashuri. Një ndjenjë të tillë ua urojmë të gjithë fëmijëve të Kosovës, sepse ne jetojmë në demokraci.



Të lumtur me rolin e gazetarit

Gazetarët, ndonjëherë, për të mësuar më shumë gjëra për temat që iu interesojnë atyre, intervistojnë qytetarë apo edhe deputetë e deputete...

Përveç shumë aktiviteteve të realizuara dhe gjërave të mësuara në Punëtorinë e Demokracisë “Demos-ti”, ishte kënaqësi që ne sot patëm rastin ta kemi për vizitë znj. Ulrike Lunacek. Lunacek ka qenë anëtare e Parlamentit të Austrisë deri në vitin 2009. Ajo tani është pjesë e Parlamentit Evropian, në të cilin ushtron edhe rol raportues për Kosovën. Për këtë arsye, ajo ndër të tjerash, ka pasur për detyrë ta shikoj punën që e bën Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës. Duke e ditur se kontributi i saj është mjaft i gjerë në fusha të ndryshme, ne nxënësit nga klasa e V-të realizuam një intervistë mjaft interesante dhe mbresëlënëse me të. Andaj, ju ftojmë t’i lexoni me vëmendje përgjigjet e dhëna nga znj. Lunacek dhe shpresojmë të merrni sa më shumë informacione nga to.

Si ndikon Parlamenti në jetën time si qytetarë?



Diellza, duke bërë pyetje për rolin e Parlamentit

Gjithçka që votohet në Parlament, ndikon edhe në shkollën tuaj. Parlamenti vendos për parat që do të shkojnë për ndërtimin e shkollave, sepse ju jeni ata që e ndërtoni demokracinë.



Lunacek duke u përgjigjur në pyetjen e Diellzës

Cili është roli i qytetarëve në demokraci?



Nxënësit e interesuar për rolin e qytetarëve në demokraci

Roli kyç i qytetarëve në demokraci është dalja në votime. Para se të dalin qytetarët në votime, duhet të informohen mirë dhe kështu ata mund të marrin vendimin më të mirë.



Znj. Lunacek, duke treguar për rolin e qytetarëve



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Latif Berisha“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V
Website: www.demos-ti.org Vendi: Dobërlukë, Vushtrri